



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:146850

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734299

KE.nr.561/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit “Ko Bake” SH.P.K., me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat në Ferizaj, kundër të paditurit Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, më datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit “Ko Bake” SH.P.K., me numër KE.nr.561/22 e datës 30.10.2020, me objekt kontesti kompensim dëmi nga aksidenti i datës 02.07.2020 i konstatuar sipas raportit të aksidentit 2020-CF-1052, kundër të paditurit Byroja Kosovare e Sigurimeve.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi “Ko Bake” SH.P.K. me datë 30.10.2020, ka paraqitur padi për shpërblimin e dëmit mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia lidhur me aksidentin e datës 02.07.2020 në Rr. “Rexhep Bislimi”, Ferizaj i konstatuar me raportin policor të aksidentit 2020-CF-1052.

Me datë 13.05.2024, paditësi me anë të parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar më datën 30.10.2020, për arsye se pas dorëzimit të padisë në gjykatë, në këtë lëndë kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore me të paditurin.

Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.561/22, datë 24.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, bazuar në nenin 261 par. 4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.